



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

DATË/A:	30.03.2018
REFERENC-Ë:	46.03.18
PËR/ZA/TO:	Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Kuvendi i Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Idriz Blakaj / Drejtor - AMKMK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i AMKMK-së

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Përmes kësaj shkrese iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2017.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2017;
- Planin e punës së AMKMK-së për vitin 2018.



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Raporti Vjetor i Punës së AMKMK-së për vitin 2017

**AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE
TË KOSOVËS**

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive	4
2. Korniza Ligjore	5
3. Fushëveprimi i Agjencisë	6
4. Organizimi i Agjencisë	7
4.1. Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2017.....	7
4.2. Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2018.....	7
4.3. Organogrami i AMKMK-së.....	8
4.4. Tabela e Trajnimeve 2017.....	9
4.5. Plani i trajnimeve të nëpunësve	10
4.6. Asetet që ka në disponim AMKMK.....	14
4.7. Hapësira për punë.....	19
5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese.....	20
5.1. Planet që parashikohen për vitin - 2018.....	21
6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit).....	23
7. Raporti Financiar.....	24
8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.....	26
9. Shtojcat.....	29

1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është themeluar në vitin 2013 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së, pas publikimit të GZRK/Nr.9/ datë 26.04.2013.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale është Institucion i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë aspekt, AMKMK do të paraqesë raportin vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet relevante dhe lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Agjencia mbikëqyrë, përkujdeset, menaxhon aktivitete të ndryshme lidhur me Komplekset Memoriale.

Agjencia bën mbrojtjen, konservimin, restaurimin, ruajtjen dhe promovimin sipas legjislacionit në fuqi.

AMKMK nxjerrë vendime, rekomandime, duke hartuar Akte nënligjore dhe nxjerrë Memorandume dhe Marrëveshje Bashkëpunimi në koordinim me nivelin lokal dhe qendror.

Në këtë raport po i përmendim objektivat kryesore që janë: Korniza ligjore, Buxheti i AMKMK-së dhe plotësimi i stafit të Agjencisë.

Arritjet e AMKMK-së për vitin e raportimit 2017 janë: përmbushja e infrastrukturës ligjore sidomos nxjerrja e legjislacionit sekondar në tërësi, realizimi i objektivave të disa projekteve duke pasur parasysh buxhetin e vogël.

Sfidat në të ardhmen mbeten rritja e buxhetit të AMKMK-së, për planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e shumë Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe shtimi i numrit të punëtorëve, si dhe bartja e të gjitha projekteve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në AMKMK.

2. Korniza Ligjore

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK-në (GZRK) Nr.9/ datë 26.04.2013, që deri me tani nuk ka pasur ndonjë ndryshim, plotësim dhe as vështirësi në zbatim të Ligjit.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Agjencia ka Rregulloren e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK.

Në këtë Agjenci janë nxjerrë këto Akte nënligjore:

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemën e Agjencisë së AMKMK-së, Rregullorja Nr.05/2016 për punët në Teren, punët Shtesë dhe Jashtë Orarit që e shfuqizon Rregulloren Nr.03/2014, Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së, Rregullorja Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave.

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz-zonë me interes të veçantë nacional ka përfunduar dhe Projektligji i ri për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz është në procedurë të mëtutjeshme të miratimit në Kuvendin e Kosovës.

3. Fushëveprimi i Agjencisë

Misioni: Krijimi i mundësisë për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në Planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës.

Vizioni: Kompletimi dhe funksionimi i Agjencisë, angazhimi në ngritjen dhe funksionalizimin e Komplekseve Memoriale, në mënyrë dhe në funksion të shtimit të numrit të vizitorëve.

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimi i programeve kërkimore - shkencore, aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimi i Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- Inicimi i procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- Hartimi i planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimi i planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- Propozon shpalljen e zonave me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës sipas organogramit ka dy Departamente: Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim i cili ende nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së buxhetit.

4. Organizimi i Agjencisë

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord.

4.1. Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2017

AMKMK në vitin 2017 ka pasur të punësuar dymbëdhjetë (12) nëpunës në këto kategori funksionale:

Nr.	Kategoritë funksionale	Numri i të punësuarve
1.	Niveli i lartë drejtues	1
2.	Niveli drejtues	4
3.	Niveli profesional	5
4.	Niveli tekniko administrativ	2

4.2. Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2018

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në vitin 2017 është plotësuar vetëm një pozitë e lirë e nivelit tekniko – administrativ, tani aktualisht janë të punësuar dymbëdhjetë (12) nëpunës, duke përfshirë Drejtorin e AMKMK-së që është i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nevojat për punëtor të rinj dhe avancimet në AMKMK parashihen:


Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:

- Zyrtar për GIS dhe IT – një (1);
- Asistente Administrative – një (1);
- Zyrtar i Logjistikës – një (1);
- Zyrtar i Pasurisë – një (1).

Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve:

- Drejtor i Departamentit Për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të K.M.-një(1)
- Arkitekt-një (1);
- Ing. të dip.të ndërtimtarisë-një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Planifikim, Projektim të K.M.- një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Menaxhim të K.M. - një (1);
- Ciceron – katër (4).

4.3. Organogrami i AMKMK-së



4.4. Tabela e Trajnimeve 2017

Nr.	Fusha e Trajnimit	Trajnimi	Muaji
1.	Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	SIMBNJ	Prill
		Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore	Qershor
		Sistemi për menaxhimin dhe Arkivimin dokumenteve(SMAED): 1. Kërkesën për hapje të llogarisë Elektronike Zyrtare 2. Kërkesë për lëshimin e kartelës identifikuese.	Nëntor
2.	Arkiva	Sistemi për menaxhimin dhe Arkivimin dokumenteve(SMAED): e-arkiva dhe protokoll.	Dhjetor
		Menaxhimi dhe arkivimi i dokumenteve	Dhjetor
3.	Buxhet dhe Financa	Trajnim i organizuar nga MF: Zbatimi i nenit 18 të Ligjit të Buxhetit për kërkuesat për transfer/riialokim. Përgatitja dhe dorëzimi i rrjedhës së parasë së gatshme në nivel të nën - kategorive ekonomike. Ndryshimet në rregulloren për raportim vjetor financiar nga OB. Demonstrim i qasjes në FTP Server për dorëzim të dokumenteve financiare.	Janar
	Buxhet dhe Financa	Punëtori e organizuar nga Kuvendi i Kosovës dhe OSCE me temat: Respektimi i formës së raportimit vjetor financiar sipas formularëve aktual dhe Shqyrtimi i raporteve vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura pa opinion e ZAP-it.	Shkurt
	Buxhet dhe Financa	Punëtori: “Raportimi Financiar – Ekzekutimi i buxhetit – sfidat dhe mundësitë”, i organizuar nga Ministria e Financave me mbështetje të USAIDT.	Nëntor

**4.5. PLANI VJETOR I TRAJNIMIT për periudhën NËPUNËSVE CIVIL Janar
2018 – Dhjetor 2018**

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësve civil që duhen trajnuar	Përshtatja * me prioritetet e trajnimit	Tirulli i programit/kursit të trajnimit dhe kuhëzgjatja e tij (nëse dihet)		Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Menaxhim i përgjithshëm	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Lidershipi dhe menaxhimi	3 ditë	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave	3	IKAP	Mars
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi dhe vendimmarrja	3	IKAP	Maj
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Bazat e menaxhimit	3	IKAP	Qershor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi Strategjik	3	IKAP	Korrik
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Sjellje organizative	3	IKAP	Gusht

	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i inovacioneve	3	IKAP	Shtator
Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi, Rekrutimi dhe përzgjedhja	3	IKAP	Shkurt
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vendosja e objektivave dhe vlerësimi të rezultateve në punë	3	IKAP	Mars
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Transferimi dhe promovimi në shërbimin civil	3	IKAP	Maj
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Ankimimi dhe çështjet e disiplinës	3	IKAP	Qershor
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe ndërtimi i planave të trajnimit	3	IKAP	Shtator
Administratë dhe Legjislacion	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartimi i koncept dokumenteve	3	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Procedura administrative	3	IKAP	Mars

	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale	Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike	3	IKAP	Prill
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Komunikimi dhe hartimi i shkresave ne administrate publike	3	IKAP	Maj
Prokurimi Publik	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi i mallrave	3	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi i Shërbimeve	3	IKAP	Mars
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale	Prokurimi për pune	3	IKAP	Prill
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Standardet Ndërkombëtar e dhe Legjislacioni i Prokurimit Publik	3	IKAP	Maj
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi elektronik – (pranimi i ankesave në mënyrë elektronike)	3	IKAP	Qershor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Trajnimit e avancuar për prokurimi publik	3	IKAP	Shtator

	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi Publik Parimet bazë Zbatimi i kontratave	3	IKAP	Tetor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Krahasimi i legjislacionit për PP me vendet e BE-së	3	IKAP	Nëntor
Buxhet dhe Financa	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Nëntë Mujore (PNM)	3	IKAP	Shkurt
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)	3	IKAP	Mars
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Kontrolli dhe Menaxhimi i Brendshëm Financiar	3	IKAP	Prill
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i financave publike	3	IKAP	Maj
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Partneriteti publiko-privat	3	IKAP	Tetor

4.6. Asetet që ka në disponim AMKMK

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizim	Vlera në libër
2014000000007377	NDËRTIMI I GYPIT PËR FURNIZIM	31400	UJESJELLESI	795,114.95	0.00	95,413.78	699,701.17
2014000000007393	KRIJIMI I WEB-FAQES SË AMKMK-	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	6,850.00	0.00	2,226.25	4,623.75
2014000000007610	DEFINIMI I KUFIRIT TE Z.V K.M	31900	KAPITAL TJETER	39,499.74	0.00	12,837.41	26,662.33
2014000000007623	MBIKQYRJEA E PROJEKTI T NDERTIM	31400	UJESJELLESI	9,780.28	0.00	1,173.63	8,606.65
2014000000008145	HARTIMI I PLANIT TË MENAXH. K	31900	KAPITAL TJETER	44,900.00	0.00	13,470.00	31,430.00
8743	NDERTIMI I RRUGËS	31200	NDERTIMI I RRUGEVE	9,870.56	0.00	1,028.19	8,842.37
8903	HARTIMI I PROJEKTI T	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,790.00	0.00	2,039.58	7,750.42
8906	MATJET GJEOMEK ANIKE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,893.00	0.00	2,143.48	7,749.52
9203	PLOTESIMI I PROJEKTI T	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,569.60	0.00	2,153.16	7,416.44
9208	KANALIZIMI T ATMOSFERIK	31250	KANALIZIMI	9,962.00	0.00	796.96	9,165.04
9211	HARTIMI I TERMAVE TE REFERENC	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,490.00	0.00	2,214.33	7,275.67
9215	ELABORATIMI I SHPRONËSIMIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,789.00	0.00	2,528.82	7,260.18
10141	MBIKQYRJEA E PUNIMEVE - PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,800.00	0.00	2,041.67	7,758.33

10146	MBIKQYR JA E PUNIMEV E - MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,689.00	0.00	1,937.80	7,751.20
10147	MBIKQYR JA E PUNIMEV E - KOSHARE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,950.00	0.00	1,990.00	7,960.00
10290	PUNËT SHITESË- MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	31,329.58	0.00	6,265.92	25,063.66
10309	SANIMI I DËMEVE- PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	30,967.74	0.00	6,193.54	24,774.20
10669	HART.PR OJEKTIT TË KONZERV IMIT	31900	KAPITAL TJETER	491,964.00	0.00	122,991.00	368,973.00
13421	VETURË KIA SPORTAG E	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	4,759.52	15,230.48
13424	VETURË KIA SPORTAG E	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	4,759.52	15,230.48
15584	EKZEKUT IMI I PUNIMEV E K.M MARINË	31900	KAPITAL TJETER	313,032.15	0.00	44,346.22	268,685.93
15590	PUNËT SHITESË- KOSHARE	31900	KAPITAL TJETER	131,222.23	0.00	21,870.37	109,351.86
15592	PUNËT SHITESË- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	29,310.38	0.00	4,885.07	24,425.31
15599	EKZEKUT IMI I PUNËVE- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	301,144.06	0.00	50,190.67	250,953.39
20316	PUNËT SHITESË- KAÇANO LL	31900	KAPITAL TJETER	6,687.80	0.00	668.78	6,019.02
20522	BAZAME NTI-HYRË EMINI- FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETER	8,061.00	0.00	806.10	7,254.90
20533	BAZAME NTI- WILLIAM WALKER- RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	69,611.70	0.00	6,961.17	62,650.53
20541	PUNËT SHITESË- BAZAME NTI RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	6,780.50	0.00	678.05	6,102.45

20582	SHTATOR JA "HYRË EMINI"- FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETER	49,500.00	0.00	4,950.00	44,550.00
20591	SHTATOR JA "WILLIA M WALKER" -RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	98,892.96	0.00	9,889.30	89,003.66
20609	K.M "DËSHMO RËT E KOMBIT"- VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	38,000.00	0.00	0.00	38,000.00
20637	DRENAZH IMI I VARREZA VE- KOSHARE	31250	KANALIZIMI	33,499.30	0.00	1,339.97	32,159.33
25227	KANALIZI MI-K.M- RAÇAK	31250	KANALIZIMI	6,019.29	0.00	60.19	5,959.10
25228	PUNËT SHITESË- K.M- RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	8,609.04	0.00	215.23	8,393.81
25711	K.M "BETEJA E KOSHAR ES"- FAZA 2	31900	KAPITAL TJETER	1,348,068.21	0.00	67,403.41	1,280,664.80
25714	PUNË SHITESË- FAZA IV- K.M- MARINË	31900	KAPITA TJETER	36,750.00	0.00	2,143.75	34,606.25
25935	K.M "BETEJA E KOSHAR ES"- FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	36,067.00	0.00	0.00	36,067.00
25938	K.M- KLEÇKË DHE DIVJAKË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	45,644.69	0.00	0.00	45,644.69
25940	NDËRTI MI I K.M- VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	205,815.75	0.00	0.00	205,815.75
25973	SHPRON ËSIMI- KLEÇKË-	32200	PASURI FIKSE E PAPREKSHME	15,500.00	0.00	775.00	14,725.00

	DIVJAKË						
25975	NDËRTIMI I SHTATOREVE-PODUJEVË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	100,000.00	0.00	0.00	100,000.00
26887	PUNË SHITESË-LIKOSHAN	31900	KAPITAL TJETER	19,447.88	0.00	324,13	19,123.75
26923	K.M"27 PRILLI"-MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	260,508.00	0.00	0.00	260,508.00
26925	PUNË SHITESË-K.M-MEJE, GJAKOVË	31900	KAPITAL TJETER	35,916.65	0.00	1,197.22	34,719.43
28224	K.M "BETEJA E KOSHARES"-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	97,162.80	0.00	0.00	97,162.80
28235	K.M "BETEJA E KOSHARES"-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	21,404.00	0.00	0.00	21,404.00
28241	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	26,880.50	0.00	0.00	26,880.52
28243	K.M "DËSHMORËT E KOMBIT"-VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	70,820.52	0.00	0.00	70,820.52
28256	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	11,970.16	0.00	0.00	11,970.16
28260	K.M "MASAKRA E RAÇAKUT"	31900	KAPITAL TJETER	109,002.00	0.00	908.35	108,093.65

28263	K.M "BETEJA E KOSHAR ES"- FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	55,277.00	0.00	0.00	55,277.00
28269	PUNIME T FAZA IV K.M- MARINË	31900	KAPITAL TJETER	374,964.93	0.00	3,124.71	371,840.22
28998	K.M "27 PRILLI"- MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	70,000.00	0.00	0.00	70,000.00
29011	K.M "27 PRILLI"- MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	3,500.50	0.00	0.00	3,500.50
29034	RISHIKI MI I PROJEKT IT TË KONSER VIMIT	32200	PASURI FIKSE E PAPREKSHME	50,000.00	0.00	0.00	50,000.00
29057	NDËRTI MI I SHTATO REVE- PODUJE VË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	80,000.00	0.00	0.00	80,000.00
29073	NDËRTI MI I SHTATO REVE- PODUJE VË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	2,000.00	0.00	0.00	2,000.00
29112	PUNËT SHITESË- VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	28,755.65	0.00	0.00	28,755.65
29253	K.M "DËSHM ORET E KOMBIT "- VRELLË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	193,225.12	0.00	0.00	193,225.12
29276	K.M "DEMË AHMETI "- PODUJE VË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	170,000.00	0.00	0.00	170,000.00
29298	NDËRTI MI I SHTATO REVE- PODUJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	48,000.00	0.00	0.00	48,000.00

	VË						
29472	K.M "DËSHM ORËT E UÇK- SË"- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	629,500.97	0.00	0.00	629,500.97
29489	PUNË SHITESË- K.M- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	60,172.01	0.00	3,008.60	57,163.41
29507	K.M "MASAK RA E LIKOSH ANIT"	31900	KAPITAL TJETER	198,999.01	0.00	0.00	198,999.01
31857	RINDËR TIMI I K.M- KAÇANO LL	31900	KAPITAL TJETER	93,300.00	0.00	9,330.00	83,970.00
				7,187,213.70	0.00	524,040.85	6,663,172.85
TOTAL:				7,187,213.70	0.00	524,040.85	6,663,172.85

AMKMK-ja, sipas ligjit obligohet të menaxhojë me të gjitha asetet e veta në Komplexet Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

4.7. Hapësira për punë:

AMKMK-ja është e vendosur në ndërtesën e objektit të ish Gjykatës Themelore Prishtinë, dhe ka hapësirë të mjaftueshme për këtë numër të stafit të punëtorëve.

5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

Aktivitetet të cilat janë ndërmarrë gjatë vitit 2017:

- Bartja e projekteve të Komplekseve dhe Memorialëve nga MMPH sipas Ligjit për Agjencinë në AMKMK ku shumica janë bartur pjesërisht, ndërsa pjesa tjetër pritet të barten deri në fund të vitit;
- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2017;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2018;
- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2017;
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2018;
- Planifikimi i personelit për vitin 2018;
- Mirëmbajtja e Web faqes së AMKMK-së dhe K.M. “Adem Jashari” Prekaz-Ritender;
- Mirëmbajtja e K.M. “Baza e Parë e UÇK-së “ në Lladovc-Podujevë ;
- Ndërtimi i Shtatoreve për “Dëshmorët e Llapit Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Konushevcu dhe Edmond Hoxha” – Podujevë;
- Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Komplekset Memoriale: Likoshan, Vrellë, Kleçkë dhe Divjakë;
- Ndërtimi i Sheshit “Hasan Prishtina” – Vushtrri;
- Realizimi në skulpturë - Shtatorja e Heroit Kombëtar “Hasan Prishtina” – Vushtrri;
- Ekzekutimi i fazës së II-të në K.M. “27 Prilli” Mejë-Gjakovë;
- Rishikimi i Projektit për Konservimin e Shtëpive të Rezistencës në K.M. “Adem Jashari”-Prekaz, Skenderaj-Ritender;
- Punët shtesë në projektin: Ekzekutimi i Fazës së IV në KM “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Marine - Skenderaj;
- Punët shtesë në projektin: Ndërtimi i Varrezave dhe Rivarrimi i Dëshmorëve të Zonës së Llapit K.M. “Dëshmorët e UÇK-së” Penuhë – Podujevë;
- Parcializimi i Hapësirës dhe rregullimi i Dokumentacionit për Leje Ndërtimore te K.M. “Dëshmorët e Kombit”, Vrelle-Istog;
- Restaurimi dhe Konservimi i Shtëpive të Familjes Ahmeti - K.M. Masakra e Likoshanit, Likoshan – Drenas;
- Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” Prekaz- Skenderaj;
- Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Ambasadorit “William Walker” – Faza II dhe Sanimi i Dëmeve në Memorialin “Masakra e Raçakut”, Raçak-Shtime;
- Ekzekutimi i Punëve në Restaurimin dhe Konservimin e Objekteve Brenda ZIV “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK – së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës;
- Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së III-të si dhe Konservimi i Kazermës dhe Istikameve në K.M. “Beteja e Koshares” – Koshare;
- Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Ambasadorit William Walker – Faza II dhe Sanimi i Dëmeve në Memorialin “Masakra e Raçakut”, Raçak-Shtime, - **Punimi i Kanalit Atmosferik dhe të Ujërave të Zeza;**
- Punët shtesë në projektin: Ekzekutimi i fazës së II-të në K.M. “27 Prilli” Mejë-Gjakovë;
- Restaurimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial, Kulla e Demë Ahmetit – Reçicë, Podujevë;

- Punët Shtese në Projektin: Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së Ambasadorit "William Walker" – Faza II dhe Sanimi i Dëmeve në Memorialin "Masakra e Raçakut", Raçak-Shtime;
- Punët Shtesë në Projektin: Restaurimi dhe Konservimi i Shtëpive të Familjes Ahmeti-K.M. Masakra e Likoshanit, Likoshan – Drenas;
- Sanimi i Dëmeve nga era dhe vërshimet në K.M. "Adem Jashari" Prekaz-Skenderaj;
- Furnizim me makinë fotokopjuese;
- Furnizim me toner për nevojat e AMKMK-së;
- FURNIZIM ME ARKIVOLE PËR KOMPLEKsin MEMORIAL "DËSHMORËT E UÇK-së" NË PENUHË – PODUJEVË;
- Punët shtesë në: Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Dëshmorët e Kombit", Vrellë-Istog;
- Furnizim me material shpenzues për nevojat e AMKMK-së.

5.1. Planet që parashikohen për vitin - 2018

- Bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK që kanë të bëjnë me komplekset dhe memorialët;
- Hartimi i elaboratit për shpronësim në Kompleksin Memorial- Demë Ahmeti, Podujevë;
- Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial Dëshmorët e UÇK-së në Penuhë, Podujevë;
- Mirëmbajtja e Memorialëve : Izbicë, Likovc, Likoshan dhe Rezallë;
- Hartimi i projektit në K.M. "Shtabi i Përgjithshëm I UÇK-së-Zona Operative e Dukagjinit", Gllogjan-Deçan;
- Furnizim me material për zyre;
- Furnizim me kalendar, kimik e material tjetër;
- Restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", Prekaz-Skenderaj;
- Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial "Masakra e Reçakut", Reçak-Shtime;
- Rregullimi i varrezave dhe rivarrimi i Dëshmorëve në KM "Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Marine, Skenderaj;
- Vazhdimi i punimeve për ndërtimin, restaurimin dhe konservimin e objekteve në K.M. ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës;
- Restaurimi dhe Konservimi i objekteve ndihmëse të familjes Ahmeti -faza II në K.M. "Masakra e Likoshanit", Likoshan – Drenas;
- Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial "27 Prilli", Meje-Gjakovë;
- Ndërtimi dhe rregullimi i sheshit "Adem Jashari", Malishevë;
- Rregullimi i varrezave të dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-së, Ismet Jashari-Kumanova, Kleçkë-Lipjan;
- Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve në Dyz-Podujevë;
- Konservimi i veturës së UÇK-së në Lupq-Podujevë;
- Rregullimi dhe riparimi i varrezave të Dëshmorëve, Negrovç-Drenas;
- Ndërtimi i Memorialit të Berishëve në qytetin e Suharekës;
- Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores "Edmond Hoxha" në Junik;

- Ndërtimi i Memorialit "Ibrahim Rugova" - faza II;
- Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse (hapja e shtigjeve dhe lapidarët përkujtimorë) në fshatin Gorozhub në rajonin e Hasit, Prizren, për dëshmorin Mujë Krasniqi dhe 40 dëshmorë të tjerë të UÇK-së;
- Sanimi i Dëmeve në ish-Qendra e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Likofc, Skenderaj;
- Ngritja e shtatores së Anton Çetës, në Prishtinë;
- Intervenimi urgjent në Kullat Jasharaj-Prekaz;
- Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari - Prekaz, Skenderaj -2017 vazhdon;
- Vendosja e Shenjave Orientuese në K.M. "Adem Jashari" – Prekaz;
- Vazhdimi i punëve për Ndërtimin, Konservimi dhe Restaurimi i Objekteve në KM ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës;
- Inicimi i procedurave për ekzekutimin e punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares-Koshare, Gjakovë - faza e tretë-2017 vazhdon;
- Ndërtimi i Memorialit "Masakra e 27 Prilli" Meje, Gjakovë-2017 vazhdon;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M "Kulla e Zahir Pajazitit"- Orllan, Podujevë-2017 vazhdon;
- Ndërtimi i Memorialit "Shtëpia e Demë Ahmetit" Podujevë-2017 vazhdon;
- Vazhdimi i Ekzekutimit të punimeve të K.M "Dëshmorët e Kombit" - Vrellë, Istog-2017 vazhdon;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit, trajnime dhe seminare;
- Mirëmbajtja e veb-faqes së AMKMK-së dhe K.M Adem Jashari, Prekaz–Skenderaj-2017 vazhdon;
- Bashkëpunimi me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Plotësimi i stafit me punëtor të ri;
- Projektligji i ri për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz është në procedurë të mëtutjeshme të miratimit në Kuvendin e Kosovës;
- Hartimi i Projekt strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së, e cila deri me tani nuk është hartuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore;
- AMKMK do të vazhdoj të parashtoj kërkesat për rritjen e stafit dhe për projekte kapitale në Ministri të Financave.

Agjencia do të bëjë përpjekje për realizimin e këtyre planeve gjatë vitit 2018.

6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Agjencia prej themelimit ka pasur shumë sfida, si mungesa e buxhetit, mungesa e stafit, ngecja dhe mos bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona, si:

- Rritja e numrit të punëtorëve të AMKMK-së: punësimi i stafit në administratë, punësimit të ciceronëve, rojeve dhe mirëmbajtja e komplekseve memoriale;

- Rritja e buxhetit për projekte kapitale - Komplekseve Memoriale;

- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe

- Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetore në këtë linjë nuk i mbulon shpenzimet për të gjitha Komplekset dhe Memorialët, andaj kërkojmë që për kryerjen e këtyre obligimeve pa probleme të ndahen mjete të mjaftueshme financiare.

Konsiderojmë se për funksionalizimin e Agjencisë duhet të merren më seriozisht Komisioni funksional BPMPH, Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe në anën tjetër edhe Qeveria dhe Ministria e Financave.

Një prej qëllimeve që ka mbetur i pa realizuar është:

- Plotësimi i stafit në të gjitha pozitat e lira, krahas kësaj edhe shtim i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Duke pasur parasysh numrin e madh të Komplekseve dhe Memorialeve në Kosovë që parashihen të ndërtohen, menaxhohen dhe disa të ndërtuara më herët që janë dëmtuar e që duhet patjetër të sanohen dhe të mirëmbahen, është e nevojshme që të kemi buxhet dhe staf të mjaftueshëm.

Planifikimi për vitin e ardhshëm do të parashihet në arritjen e këtyre objektivave, me qëllim të ngritjes, menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve që janë përgjegjësi e AMKMK-së, përkatësisht bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve me institucionet tjera relevante.

Stafi i AMKMK-së është trajnuar dhe kualifikuar për punët dhe detyrat shtesë të domosdoshme për funksionimin më të mirë të Agjencisë.

7. Raporti Financiar

Buxheti fillestar për AMKMK-në për vitin 2017 ishte: 3,911,878.00 €; Buxheti me Rishikim Buxhetor 2017: 2,841,878.00 €; Buxheti final: 3,231,838.83€.

Kategoritë	Buxheti fillestar	Buxheti me rishikim buxhetor	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet 2017	%
Paga e mëditje	87,007.00	87,007.00	86,879.44	86,600.12	99.67
Mallra e shërbime	44,871.00	74,871.00	65,034.24	53,351.19	82
Shpenzim et komunale	30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00	100
Investimet kapitale	3,750,000.00	2,650,000.00	3,049,925.15	3,005,930.84	98.55
Totali	3,911,878.00	2,841,878.00	3,231,838.83	3,175,882.15	98.26

Me buxhetin e vitit 2017 kanë qenë të lejuar dymbëdhjetë (12) pozita për AMKMK-në dhe janë të plotësuara të gjitha pozitat.

Ndarja finale e buxhetit ka ndryshuar për shkak të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/19 më dt. 15.12.2017, për tërheqjen e mjeteve të lira, transferit/rialokimit të mjeteve dhe shtim të mjeteve.

Kursimet janë bërë në këto kode ekonomike:

13310: 300.00€; 13330: 300.00€; 13440:400.00; 13503: 800.00€; 14210: 140.00€; 13951: 141.00€

Ndarje buxhetore kemi pasur te këto projekte kapitale:

14651 Kompleksi Memorial “Masakra e Likoshanit”, Likoshan: 20,000.00€

15389 Ndërtimi i shtatoreve të heronjve të Llapit: 80,000.00€

15044 Memoriali Meje Gjakovë: 70,000.00€

15391 Kompleksi Memorial Demë Ahmeti: 170,000.00€

14363 Memoriali i dëshmorëve Penuhë: 60,000.00€

Transfer/rialokim:

Nga kodi i projektit 15392 në kodin e projektit 15390 transferi me shumë prej 50,000.00€.

Ndërsa te mallrat e shërbimet kemi pasur ngritje të buxhetit për shkak të kërkesës tonë për blerjen e arkivoleve në K.M Dëshmorët e UÇK-së, e cila kërkesë është aprovuar.

Transfer/rialokim brenda kategorisë mallra e shërbime pa e rritur shumën totale kemi pasur në këto nën kategori ekonomike:

Nga kodi 13780 karburante për automjete transfer/rialokim në nënkategorinë 14010 mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve me vlerë prej 1,000.00€.

Transfer/rialokim nga kodi 13460 shërbime kontraktuese tjera me vlerë 1,912.00€; nga kodi 13410 shërbimet e arsimit dhe trajnimit me vlerë 1,700.00€; nga kodi 13450 shërbime shtypje jo-marketing me vlerë 1,500.00€; nga kodi 13501 mobile më pak se 1000€ me vlerë 1,600.00€; nga kodi 14220 botimet e publikimeve me vlerë prej 1,000.00€, gjithsejt 7,712.00€ në kodin 13509 pajisje tjera <1000.

Transfer/rialokim kemi pasur edhe përbrenda kategorisë së shpenzimeve komunale ku nga kodi ekonomik 13220 shpenzimet e ujit janë transferuar në kodin 13210 shpenzimet e energjisë elektrike me vlerë prej 500.00€, pa e ndryshuar vlerën totale të shpenzimeve komunale.

***Me rishikim buxhetor** - Vendimi i qeverisë nr. 01/151 me dt. 02.08.2017 ka marrë vendim për tërheqjen e fondeve të mjeteve të pa shpenzuara dhe mjeteve të zotuar të pashpenzuara të tërhiqen mjetet 100% dhe 80%. AMKMK-së i janë ngrirë mjetet në këto projekte kapitale :

Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, Prekaz: 200,000.00 (100%).

Kompleksi Memorial “Demë Ahmeti”, Podujevë: 250,000.00 (100%).

Rregullimi i varrezave në Polac : 250,000.00 (100%).

Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit Adem Jashari, Malishevë: 20,000.00 (100%).

Kompleksi i varrezave të dëshmorëve Brigada 121 UÇK-së I Jashari, Kleçkë: 30,000.00 (100%).

Restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në lagjen Jasharaj: 150,000.00 (80%; 30,000.00).

Ndërtimi i sheshit Hasan Prishtina: 250,000.00 (80%; 50,000.00).

Por në SIMFK buxheti final i këtyre projekteve ka figuruar i njëjtë sikurse në buxhetin fillestar por mjetet nuk kanë qenë të alokuara.

Këtij Raporti Vjetor të Punës do t’ia bashkangjesim edhe Raportin Vjetor Financiar 2017 të AMKMK-së.

8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Po ashtu duhet siguruar që shpenzimet e mirëmbajtjes të mos regjistrohen në regjistrin e pasurive pasi që ato nuk mund të trajtohen si pasuri.	Pajtueshmërine me Rregullën Financare nr. 03/2013; Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048; Regjistrimi i pasurive	Gjatë vitit 2017	Pasqyrimi i drejtë i PVF
2	Zbatimin i planit të veprimit, I rishikuar, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të AP.	AMKMK gjatë këtij viti është munduar që të zbatoj rekomandimet e AP.	Gjatë vitit 2017	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve ndikon në kontrollet e brendshme të shfaqen dobësi të vazhdueshme.
3	Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit. Pyetësi i vet-vlerësimi i plotësuar nga AMKMK-ja ka vërtetuar se ka procedura formale të dokumentuara, pasi është hartuar lista e rreziqeve dhe plani i menaxhimit të rreziqeve.	AMKMK ka themeluar grupin punues për hartimin e strategjisë gjithëpërfshirëse por kemi mungesë të mjeteve. Monitorimi dhe raportimi mbi planin për menaxhimin e rreziqeve duhet të bëhet në baza të rregullta kohore.	Gjatë vitit 2017	Mungesa e Strategjisë shkaktonte paqartësi rreth misionit, vizionit dhe synimeve të organizatës.

4	Monitorimi i performancës buxhetore dhe realizimi I projekteve në baza mujore dhe identifikimi, adresimi me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.	AMKMK gjatë këtij viti është munduar që realizimin e buxhetit të projekteve ta bëjë sipas planifikimit.	Gjatë vitit 2017	Mbetja e shumë pagesave në fund të vitit mund të shkaktojë ngarkesë dhe mund të ketë mos aplikim efektiv të kontrolleve.
5	Plotësimi i pozitive me zyrtar permanent për çertifikim dhe për menaxhim të pasurisë.	AMKMK ka mungesë të mjeteve në paga e mëditje për plotësimin e pozitive.	Gjatë vitit 2017	Ushtrimi i dy e më shumë pozitive brenda një insititucioni nga I njëjti zyrtar rrezikon procesin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, gjithashtu rezulton në konflikt interesi.
6	Sigurimi që në të ardhmen të mos ndodhin pagesa në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullave financiare.	AMKMK gjatë këtij viti ka marrë parasysh vërejtjen dhe janë marrë masa të mos ndodhin gabime të tilla.	Gjatë vitit 2017	Rreziku që të ndodhin pagesa jashtë kontrollove të duhura.
7	Sigurimi që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara në mënyrë që të shmang kostot shtesë.	Projektim më i mirë i projekteve.	Gjatë vitit 2017	Planifikimet jo të mira të projekteve ndikojnë edhe në planifikime jo adekuate buxhetore.

8	Sigurimi që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen nga komisioni i përbërë nga tre vetë.	AMKMK gjatë vitit 2017 gjithmonë e ka bërë pranimin e mallit nga komisioni prej tre vetëve.	Gjatë vitit 2017	Pranimi i furnizimeve në mungesë të komisionit dhe pa aplikuar kontrollet e nevojshme, rrit rrezikun që të pranohen furnizime të cilësisë jo të mirë.
---	---	---	------------------	---

9. Shtojcat

Në AMKMK janë nxjerrë Vendime të rëndësishme si:

- Vendime për Formimin e Komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e Ofertave -AMKMK;
- Vendim për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendime për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projekteve ideore, kryesore në konservimin dhe restaurimin objekteve memoriale të ndryshme;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për Komisionin Konteste dhe Ankesa dhe Komisionin për Shkelje Disiplinore;
- Vendim për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;
- AMKMK nuk ka Bord dhe nuk është Autoritet Rregullativ nuk lëshon dhe revokon Licenca.

Për realizimin e objektivave të AMKMK-së, është me rëndësi të ketë rritje të Buxhetit të Agjencisë nga Ministria e Financave. Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare dhe mos trajtimi me kompetencë i kësaj çështje nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës është dhe mbetet pengesa kryesore në arritjen e objektivave të parashikuara të Agjencisë.

AMKMK do të përmbushë në mënyrë efikase dhe me integritet detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i rregullon Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Me respekt.